VENDIM
Nr. 668, datë 8.10.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E PËRRENJASIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike, në bashkinë e Përrenjasit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Përrenjasit .
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3900 m^2 tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme 3 120 000 (tremilionë e njëqind e njëzet mijë) lekë.
4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Investimeve për shërbime publike", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë dhe të përballohet nga buxheti i vitit 2004, miratuar për bashkinë e Përrenjasit.
6. Shpronësimi të fillojë më datë 1 nëntor dhe të përfundojë më datë 30 nëntor 2004.
7. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetari i bashkisë së Përrenjasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIK NË PËRRENJAS

Nr.	Emri, mbiemri	Sip. Tokë truall m^2	Njësia lekë m^2	Vlera lekë
1.	Shahin Rushan Kukli	3 900	800	3 120 000
	Totali			**3 120 000**